

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Korçë, më 25.04.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** "Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit të faturimit Al-Billing, sistemit WAMR , SQL Server Oracle Database, Omega Core Audit".

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 72211000-7  
Shërbim programimi për sisteme kompjuterike dhe për përdorues.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 2.758.200 (dymilioneshtatëqindpesëdhjetëtetëmijëedyqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 55.164 (pesëdhjetëepesëmijëenjëqindegjashtë dhjetëekatër) lekë (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.*

K.Dishnica

K. Bojko

E. Bicolli

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1.103.280 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.** Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, si dhe sipas parashiktimit të nenit 55 të Rregullave të PP.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet, *kur përmasat nuk dihen*, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A, për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

K.Dishnica

K. Bojko

E. Bicolli

## **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 551.640 lekë pa TVSH .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të Rregullave të PP ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

" Për kontratat e shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës."

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ( $20\% \times 2.758.200 \text{ leke} = 551.640 \text{ leke}$ ) . Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

K. Bojko

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

b) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën ISO 27001:2013 mbi “Sistemet menaxhimit të sigurisë së informacionit”, e vlefshme (ose ekuivalente). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre përsipër sipas akt-marreveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

*ISO 27001 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin të sigurt të informacionit të cilësisë të shërbimeve që kërkohen dhe lidhen me sistemet e teknologjise së Informacionit. Ky lloj certifikimi garanton AK se operatori ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të sigurt për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi.*

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve:

- Për Programin Kompjuterik “Al Billing”
- Për sistemin Omega Core Audit të bazës së të dhënave

K. Bojko

Autorizimi (ose Kontrata e Bashkepunimit) duhet të lëshohet për këtë procedurë dhe drejtuar Autoritetin Kontraktor, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Aktualisht Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë (SHRUKK) përdor:

- Sistemin e faturimit AI-Billing me të drejtë autori rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA për kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalent për programin kompjuterik "AI-Billing".
- Sistemin Omega Core Audit me të drejtë autori të regjistruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Certifikatë Regjistrimi Nr. TXu 1-976-534, ose ekuivalent për Sistemin Omega Core Audit.

Suporti i prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e suportuesve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës dhe respektimin e të Drejtës së Autorit. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Komponentet e mësipërm, vlerësohen si më të rëndësishmit e shërbimit të cilat duhet të kenë mbështetjen e prodhuesit.

**4.** Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të angazhohet në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje infrastrukture;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje e Programit Kompjuterik AI Billing
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim në web/mobile;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit

*Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

K. Bojko

b. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

**Shënim:** Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit*, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) Mirëmbajtja e Infrastrukturës ku janë të Instaluar Sistemet si ai AI Billing, WAMR apo Omega Core, kërkon njohuri specifike për cilat lidhet jo vetëm me njohjen e sistemeve në vetvete por edhe me njohjen e sistemeve të tjera të operimit apo makinave virtuale. Certifikimi i këtij lloji garanton OE që infrastruktura do të mirëmbahet dhe do të sigurohet mbarvajtja e punës. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve.
- b) Punonjësi i certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni AL-Billing nevojitet për zhvillimin, përshtajen si dhe përmirësimin e sistemit AL-Billing. Kjo kërkesë bazohet në termat e referencës së projektit ku operatori duhet të jetë në gjëndje të mirëmbajë, përshtasë programin në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga SHRUKK.
- c) Punonjësi i certifikuar për zhvillim në web/mobile. Kjo kërkesë mbështetet në termat e referencës së shërbimit, ku operatori duhet të jetë në gjëndje të përshtasë programin në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga SHRUKK. Sistemi AL-Billing mbështetet në teknologjinë web, ndërsa disa pjesë të rëndësishme të sistemit bazohen në programin me teknologji mobile.
- d) Punonjësi i certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit. Kjo kërkesë mbështetet në termat e referencës së shërbimit, ku operatori duhet të jetë në gjëndje të mirëmbajë por edhe implementojë politika të reja mbi sigurinë për identifikimin e ndërhyrjeve të pa autorizuara në bazat e të dhënave, komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga SHRUKK.

**5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në të cilën merr përsipër mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AI-Billing, mirëmbajtjen e Sistemit WAMR, mirëmbajtjen e SQL Server dhe Oracle Database, si dhe mirëmbajtjen e Omega Core Audit për një periudhë 9 mujore.

K. Bojko

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Kërkohen shërbimet: ”Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit të faturimit Al-Billing, sistemit WAMR , SQL Server Oracle Database , Omega Core Audit”.**

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi njësi	Vlera
1	Mirëmbajtje dhe përmirësime të Sistemit të Faturimit Al-Billing	9 muaj		
2	Mirëmbajtje dhe përmirësime të Sistemit WAMR	9 muaj		
3	Mirëmbajtje dhe përmirësime të SQL Server dhe Oracle Database	9 muaj		
4	Mirëmbajtje dhe përmirësime të Omega Core Audit	9 muaj		
	VLERA (lekë pa TVSH)			
	TVSH (20%)			
	TOTALI ME TVSH (lekë)			

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë me 56000 abonentë përdor aktualisht për Administrimin e Abonentëve, Faturimin, Arkëtimin, Ankesë/Kërkesat, Faturën Online sistemin e faturimit AL-BILLING, Web Service të Pagesave dhe atë të Leximeve për realizimin e leximeve të matësave nga Lexuesit në terren dhe administrimin e tyre (marrjen online dhe kalimin e tyre për faturim), administron edhe sistemin WAMR për administrimin e matësave smart elektronike dhe informacionit të tyre. Gjithashtu SHRUKK përdor për sigurinë dhe kontrollin e bazës së të dhënave Omega Core Audit.

Si rrjedhojë lind nevoja për kryerjen e mirëmbajtjes së sistemeve të përmendura më lart.

K. Bojko

### **Mirëmbajtja e Sistemit WAMR**

Kërkohet që të mirëmbahet sistemi i leximeve të matësve elektronike WAMR. Mirëmbajtja do të shtrihet në mirëmbajtjen e makinave virtuale ku është i instaluar Sistemi WAMR me IIS, si dhe baza e të dhënave SQL Server. Me mirëmbajtjen e sistemit WAMR sigurohet mbarëvajtja e punës së këtij sistemi dhe sigurimi i leximeve të matësve elektronikë të ujit.

### **Mirëmbajtja e SQL Server dhe Oracle Database, të Sistemit të Faturimit Al-Billing**

Kërkohet që të mirëmbahen bazat e të dhënave SQL Server ku bazohet sistemi WAMR dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave Oracle Database ku bazohet sistemi i faturimit Al-Billing.

Mirëmbajtja e bazave të të dhënave duhet të garantojë vijimësinë e shërbimit dhe në rastet e problematikave zgjidhjen dhe vendosjen në funksion duke kthyer shërbimin e sistemeve Al-Billing dhe WAMR.

### **Mirëmbajtja e Omega Core Audit**

Kërkohet që të mirëmbahet sistemi Omega Core Audit, mirëmbajtja e këtij sistemi shumë të rëndësishëm për sigurinë e aksesimit të të dhënave. Kërkesa shtrihet edhe me instalimin e versioneve të reja të sistemit duke mbuluar të gjithë aspektet e sigurisë dhe raportimit.

## **QËLLIMI I PUNËS**

### **Të përgjithshme**

Institucioni administrues pranë të cilit do të realizohet mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemin AL-BILLING, sistemit WAMR, bazave të të dhënave dhe Omega Core Audit do të jetë Shoqëria Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë (SHRUKK).

Mirëmbajtja do të mundësohet edhe nga distanca (remote), ndërsa prezantimet dhe testimet do të bëhen fizikisht në zyrat e SHRUKK së bashku me stafin e IT dhe atë përgjegjës sipas moduleve.

### **Kërkesat funksionale**

Kërkesat funksionale do të jenë të listuara sipas pikave kryesore që do të realizohen si objekt i këtij prokurimi lidhur me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e Sistemit të Faturimit Al-Billing, WAMR, SQL Server dhe Oracle, si dhe Omega Core Audit për Shoqërinë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë (SHRUKK).

K. Bojko



## **Mirëmbajtje, zhvillime dhe përmirësime të Sistemit të Faturimit Al-Billing**

Kërkoheq që të mirëmbahet apo edhe rishikohen/përmirësohen aty ku shikohet e nevojshme të gjithë format e regjistrimit dhe administrimit të të dhënave me qëllim administrimin e informacioneve të reja si dhe azhornimin e atyre egzistuese duke mos u kufizuar vetëm në fusha por edhe funksione.

Pika kryesore që do të mirëmbahen janë:

- ✓ Mirëmbajtja dhe përshtatja e formave të administrimit të abonentit dhe të dhënave të lidhura me të dhe kufizimi për marrjen e të dhënave të detyrueshme si NID, NIPT, etj.
- ✓ Mirëmbajtja e kontrolleve dhe përshtatjeve për njohjen dhe kontrollin e NID si element të detyrueshëm
- ✓ Mirëmbajtja e opsionit të printimit të kontratës tip për të gjithë klientët e SHRUKK përfshirë klientët ekzistues si dhe të ri
- ✓ Mirëmbajtja i statuseve të kontratave të abonentëve
- ✓ Mirëmbajtja e zonave të furnizimit dhe saktësimi i abonentëve për secilën zonë dhe grup operativ
- ✓ Mirëmbajtja dhe azhornimi i formës së regjistrimit të matësave dhe të formularit të montimit
- ✓ Mirëmbajtja, identifikimi dhe kontrolli i numrave serialë të matësave dhe njoftimi për dublikata dhe mos lejimi i tyre për regjistrim
- ✓ Mirëmbajtja e administrimit të listës së lexuesve dhe lidhja e tyre me **UK Reader** në formë automatike referuar sinkronizimeve
- ✓ Mirëmbajtja e indeksimit të abonentëve sipas vendndodhjes dhe rrugëve, referuar nevojës si dhe specifikimeve të SHRUKK
- ✓ Mirëmbajtja në faturë e njoftimit të detyrimit si me vlerë ashtu edhe me numër faturash
- ✓ Mirëmbajtja e formës së kontrollit për abonentë pasivë dhe rasteve me anomali me qëllim faturimin e saktë të taksave dhe tarifave
- ✓ Mirëmbajtja e formës së administrimit të tarifave që të jenë dinamike dhe ndahen në dy tarifime referuar përqindjes së faturimit apo kërkesave të ujësjellësit, dinamike kjo mujore
- ✓ Mirëmbajtja e zonave dhe nënzonave të faturimit dhe përshtatja e tyre me të dhënat e Bashkive dhe Njësi Administrative
- ✓ Mirëmbajtja, përmirësimin dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët, fotot e matësave, etj.)
- ✓ Mirëmbajtja dhe saktësim të raporteve për faturimin dhe debinë sipas zonave dhe njësi, referuar edhe volumit të të dhënave
- ✓ Mirëmbajtja e arkave, bankave apo kanaleve të tjera të pagesave online si dhe lidhjeve të tyre automatikisht në sistem

K. Bojko

- ✓ Mirëmbajtja e modulit të konsultimit të faturës Online me ndryshimet e shtuara në sistemin AI-Billing dhe reflektimin e saktë të të dhënave
- ✓ Mirëmbajtja e opsionit të identifikimit nëpërmjet email dhe lehtësimi i konsultimit online
- ✓ Mirëmbajtja e të drejtave në nivel database për përdoruesit e skemave apo mënyrës së sinkronizimeve
- ✓ Mirëmbajtja e procesit të punës duke përfshirë administrimin e formave të regjistrimit nga grupet e punës në terren

Mirëmbajtja e raportimit të faturimit në numrin e leximeve si dhe sasinë m3 referuar lexuesëve si dhe zonave

### **Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Operatori ekonomik**

- ✓ Mirëmbajtja dhe përmirësimi i Sistemit të Faturimit AI-Billing dhe përshtatja me kërkesat e SHRUKK.
- ✓ Mirëmbajtja, identifikimi dhe kontrolli i numrave serialë të matësave dhe njoftimi për dublikata dhe mos lejimi i tyre për regjistrim
- ✓ Mirëmbajtja i statuseve të kontratave të abonentëve
- ✓ Përmirësimi dhe saktësim të raporteve për faturimin dhe debinë sipas zonave dhe njësive, referuar edhe volumit të të dhënave, sipas kërkesave të kërkuara dhe ndryshuara shpesh herë nga SHRUKK.
- ✓ Shtimi i raporteve sipas kërkesave të SHRUKK
- ✓ Përmirësimi i bazës së Abonentit duke shtuar opsionin për identifikimin e klienteve debitorë që e kanë linjën të taposur por kontrata vazhdon të jetë aktive.
- ✓ Mirëmbajtja dhe përmirësimi i modulit të administrimit të abonentëve duke mundësuar kontrollet e nevojshme si dhe shtuar informacionin e nevojshëm. (Te kemi mundësi të identifikojmë në sistem klientet me matës të perbashkët si dhe klientet me dy kolla të cilët faturohen në shtyllen pa matje)
- ✓ Mirëmbajtja e modulit të administrimit të tarifave, duke e sjellë në linjë me administrimin e saktë të tarifave dhe taksave.
- ✓ Mirëmbajtja e Sistemit të Faturimit AI-Billing për shtimin e mundësive të pagesave pjesore apo atyre kreditore
- ✓ Mirëmbajtja dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët)
- ✓ Mirëmbajtja e Sistemit duke mundësuar analizimin e menjëhershëm të planit të faturimit me faturimin mujor.
- ✓ Mirëmbajtja dhe azhurnimi i Modulit të Faturës Online duke reflektuar të gjithë ndryshimet e faturës apo ndryshimeve tek abonentit

K. Bojko

- ✓ Mirëmbajtja e Sistemit të Faturimit Al-Billing , përfshirë administrimin e plotë të Akt-Marrveshjeve duke mundësuar më shumë se një akt-marrveshje, analizën automatike të tyre lidhur me respektimin dhe lejuar pagesat e kësteve duke i reflektuar ato saktë në raporte dhe shfaqja e kësteve mujore të akt-marrveshjes në faturë.
- ✓ Mirëmbajtja e modulit të raportimit duke lejuar IT në nivel përdoruesi aplikimi të krijojnë raportet e nevojshme
- ✓ Ruajtja e historikut të ndryshimeve të leximeve, faturimeve dhe arkëtimeve
- ✓ Shpjegimin e zhvillimit dhe përshtatjeve të sistemit të personelit te IT
- ✓ Mirëmbajtjen e Sistemit të Faturimit Al-Billing
- ✓ Mirëmbajtjen e modulit të Faturës Online
- ✓ Mirëmbajtjen e modulit të Pagesave Online
- ✓ Mirëmbajtjen e modulit të Leximeve nëpërmjet PDA
- ✓ Mirëmbajtjen e sistemit të auditimit të bazave të të dhënave Omega Core Audit
- ✓ Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të leximeve të matësave elektronikë WAMR.
- ✓ Mirëmbajtjen e SQL Server dhe Oracle Database.

## **SUPOZIMET DHE RRISQET**

### **Supozimet e Shërbimit**

Realizimi i këtij shërbimi bëhet nën supozimin që do të ketë një përfshirje totale të aktorëve kyç si në mirëmbajtjen dhe përmirësimin i sistemit Al-Billing, mirëmbajtjen e Sistemit WAMR, mirëmbajtjen e SQL Server dhe Oracle Database, Mirëmbajtjen e Omega Core Audit.

Përfshirja e plotë e aktorëve kyç është thelbësore për mbarëvajtjen me sukses të shërbimit.

### **Rrisqet**

Mos përfshirja e të gjithë aktorëve kyç do të sjellë mangësi në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemeve e si pasojë të ndikojë në sigurinë, punën dhe proceset e SHRUKK.

### **Siguria e Sistemit**

Kërkesat për sigurinë e sistemit janë të përcaktuara qartësisht në Sistemin Omega Core Audit dhe mirëmbajtja e këtij sistemi apo rishikimi I politikave të sigurisë janë objekt i kësaj mirëmbajtjeje.

Çdo përdorues do të njihet nga sistemi në mënyrë që ai të ketë të drejtë të hyjë në të me anë të identifikimit me përdorues unik dhe fjalëkalimin e tij personal. Vetëm pas identifikimit të tij me të drejta plotësisht të përcaktuar, ai mund të vijojë me punën.

K. Bojko

Të gjithë të dhënat e ruajtura në aplikacion, përfshirë edhe ato të konfigurimeve si dhe të përdoruesëve të sistemit duhet të ruhen në një bazë të dhënash RDBMS e cila plotëson kërkesat në lidhje me integritetin e të dhënave dhe sigurisë.

Sistemi duhet të suportojë mjete efikente auditimin, aktivizimin e ruajtjes së historikut dhe të ndryshimeve, përcaktimin e historikut të të gjithë veprimeve të të shkuarës dhe të ardhmes (modifikim, shtim, fshirje). Ruajtja të realizohet për të dhëna specifike në tabela dhe forma të cilat mund të zgjidhen nga administratorët e sistemit.

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, argumentojmë që shërbimet duhet të prokurohen në një prokurim, pa ndarje në lote :

Kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në lote sepse nga vetë objekti i prokurimit kemi të bëjmë me një shërbim i cili lidhet me përditësimin dhe mirëmbajtjen e disa sistemeve teknologjike të cilat janë të ndërthura me njëra tjetrën dhe janë pjesë e një procesi pune që ka si rezultat ofrimin e shërbimit të pagesave tek konsumatorët. Procesi i faturimit është hallka e parë e cila është e ndërlidhur detyrimisht me dy sistemet e tjera UK Reader dhe WAMR dhe rrjedhimisht edhe me Omega Core.

Paralelisht me këtë proces kryhet kalimi i të dhënave të leximeve në terren në sistemin AI-Billing, nga ku përpunohen këto të dhëna dhe gjenerohet fatura mujore e cdo konsumatori. Në treg gjenden lehtësisht disa operatorë ekonomikë, që mund të ofrojnë të gjitha këto shërbime.

**Afatet e ekzekutimit të shërbimeve:** 9 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Klea Bojko**